



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Aritech ShPK” të datës 29.10.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 24.10.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ritender Furnizim me kompjuter për drejtorinë e transformimit dhe urbanizmit” me nr. të prokurimit 616-24-9745-5-5-8, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Aritech ShPK” të datës 29.10.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 24.10.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ritender Furnizim me kompjuter për drejtorinë e transformimit dhe urbanizmit” me nr. të prokurimit 616-24-9745-5-5-8.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik “Aritech ShPK” (tutje “parashtruesi”) me datë 29.10.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 24.10.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ritender Furnizim me kompjuter për drejtorinë e transformimit dhe urbanizmit” me nr. të prokurimit 616-24-9745-5-5-8.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.


## Pretendimet ankimore të parashtruesit:

OE Ilir Kosova Shpk ka ofertuar me modelin **HP Elite Tower 800 G9**.

Per te njejten ka vendosur broshuren e prodhuesit, e cila nuk e ploteson specifikimin teknik. Modeli HP Elite Tower 800 G9 nuk e perkrah kartelen grafike 16GB ashtu siç kerkohet ne dosje te tenderit.

Perveç kesaj Grafika e ofertuar nga OE qe mendohet te shperblehet me kontrate nuk eshte ne perputhje me rekomandimet per power supply.

Arkitektura e series HP Elite nuk eshte ndertuar ne ate menyre qe te suportoj karteles grafike 16GB, perveq pjeses se funksionalitetit optimal te grafikes ky model power supply maksimal qe ka ne konfigurim eshte 550W, nderkohe qe ajo minimale per funksion optimal te karteles grafike ne fjale nevojitet powersupply 600W



Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se kërkesa për të cilën bëhet fjalë është si në vijim:

|                         |  |
|-------------------------|--|
| <b>Kartela Grafike:</b> | <b>min.16 Gb GDDR6, dy porte: HDMI+DP (16Gb minimumi që i plotëson kushtet për punë në drejtorinë e Transformimit dhe Urbanizimit)</b> |
|-------------------------|--|

Komisioni vlerësues i përbërë nga anëtarë profesional të fushës pas ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit me kujdes të ofertës së tenderuesit të rekomanduar ka gjetur se produktet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar i plotësojnë kushtet për punë në drejtorinë përkatëse si dhe e përkrahin kartelën grafike min. 16 GB GDDR6 sikurse është kërkuar në ftesë/dosje. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka prezantuar ndonjë argument të qëndrueshëm sipas të cilit do të argumentonte arsyen pse produktet e tenderuesit të rekomanduar nuk përkrahin kartelën grafike min. 16 GB. Ndërsa sa i përket pjesës së pretendimit ankimor ku parashtruesi citon nga interneti disa rekomandime për power supply të kartelës grafike, duhet cekur se kjo nuk ka qenë kërkesë e dosjes/ftesës dhe nuk mund të trajtohet si pretendim.


Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 04.11.2024

  
Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimin të këtij vendimi.